| **Titulli/Emërtimi i projektit** | **Rikonstruksion i Qendrës së Kulturës, Bulqizë.** |
|---|---|
| Tipi i projektit | Qendër Kulturore |
| Vendndodhja e projektit | Njësia Administrative Bulqizë |
| Buxheti total i projektit | 33,147,876 me tvsh ALL |
| Përshkrimi i projektit | Qendra Kulturore e qytetit të Bulqizës është ndër ambientet kryesore ku misioni i saj është bashkimi dhe shkëmbimi i eksperiencave midis profesionistëve të rinj, si dhe promovimi i aftësive krijuese të secilit anëtar. Ajo ka pësuar dëmtime të herëpasherëshme me kalimin e kohës. Godina asnjëherë nuk ka pasur një rikonstruksion tërësor. Gjendja në të cilën ndodhet godina është një pengesë serioze për protagonistët e aktiviteteve të moshave të ndryshme. Është vlerësuar si prioritet përmirësimi dhe rikonstruksioni i plotë i saj.<br>Përfituesit do të jenë në numër të shumtë pasi bëhet fjalë për një ambient ku zhvillohen shumëllojshmëri aktivitetesh.<br>Përafërsisht numri i tyre shkon 7000 qytetarë. |
| Qëllimi dhe objektiva | Qëllim i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetësës, me objektiv<br>♣Është përmirësimi dhe modernizimi i Qendrës Kulturore<br>♣Krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për aktivitete e ndryshme<br>♣Rritjen e interesit të pjesëmarrësve për tu bërë pjesë e aktiviteteve të ndryshne<br>♣Ndërgjegjësimin e qytetarëve për mirëmbajtjen e ambjentit<br>♣ Të rriten mundësitë për zhvillim social-ekonomik |
| Rezultatet e pritshme | Rezultatet e pritshme të projektit janë<br>♣Mjedis fizik i përshtashëm për qytetarët e të gjithë njësive administrative Bulqizë.<br>♣Cilësia e rritjes së zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme me anë të video projektorëve të kohëve modern..<br>♣Kapacitete të përmirësuara të qeverisjes vendore për administrimin dhe mirëmbajtjen e Qendrave Kulturore |
| Rendi prioritar | Projekti është në rendin prioritar për vitin 2020 |
| Qendrueshmëria e projektit | Pranë bashkisë do të ngrihet njësia për administrimin dhe mirëmbajtjen e Qendres Kulturore. Fondi për administrimin dhe mirëmbajtjen e Qendrës do të parashikohet çdo vit në buxhetin e bashkisë. |

| | |
|---|---|
| Aktivitetet e projektit | ♣ Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër<br>♣ Miratimi i lejeve administrative<br>♣ Zbatimi i projektit |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis | Ka ndikim në mjedis, por në bazë të masave zbutëse të propozuar në studimin e ndikimit në mjedis do të minimizohet ndikim |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim | Projekti për përmirësimin e këtij segmenti është i hartuar dhe ndodhet në bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis. |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar | Projekti ka qenë në listën e prioriteteve për investime të Njësisë Administrative Bulqizë sipas Planit strategjik të zhvillimit |